



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA Durrës  
KËSHILLI BASHKIAK

**PROÇESVERBAL**

**Nr. 21, datë 25.11.2021**

**I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës për muajin Nëntor, që zhvillohet tek salla e Qendrës Kulturore “Aleksandër Moisiu”**

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:05

Data e mbajtjes së mbledhjes : 25.11.2021

Mbajtja e mbledhjes : salla e Qendrës Kulturore “ Aleksandër Moisiu”

Lloji i Mbledhjes: **Mbledhje e Rradhës**

**Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës** : Znj.Emiriana Sako, që kryen funksionet e Kryetarit Bashkisë dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

**Ani Dyrmishi** : Përshëndetje të gjithëve !

Përpara se ta fillojmë mbledhjen do të dëshiroja nga ana e gjithë këshilltarëve të mbani një minutë heshtje në nder të sportistit të njohur të qytetit tonë Vladimir Ajazi dhe në kujtim të viktimitave të tragjedisë së Bullgarisë, të 46 personave që humbën jetën.

*(Mbahet një minut heshtje, të gjithë në këmbë)....*

Faleminderit të gjithëve.

Të nderuar Këshilltarë ! E nderuar Kryetare ! Të nderuar pjesmarrës!

E deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak Durrës.

Në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe miratojmë disa projektvendime të propozuara nga Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako. Materialet siç jeni të gjithë në dijeni Ju janë vënë në dispozicion nga Sekretaria e Këshillit Bashkiak.

Ftoj Sekretaren e Këshillit të bëj dhe prezencën e këshilltarëve.

**Dorina Milja**: Përshëndetje të gjithëve! Fillojmë me prezencën. Jolanda Mustafaraj ... prezent.....etj..... Morena Boja.....prezent. Kryetar ke 35 këshilltarë në sallë.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Meqë kuorumi është i pranishëm vazhdojmë me rendin e ditës. Siç jeni vënë të gjithë në dijeni sot kanë qënë 10 pika për tu shqyrtuar në rendin e ditës, por 2(dy) pika janë hequr me kërkesë të Bashkisë, kështu do të procedojmë me 8 (tetë) pika. Po vazhdoj me leximin e rendit të ditës.

1. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI NGA TË ARDHURAT E BASHKISË, PËR MUAJIN NËNTOR 2021
2. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E NGRITJES, PËRBËRJES DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLIT TEKNIK KONSULTATIV PRANË BASHKISË DURRËS
3. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT KUNDREJT TARIFËS, TË PALESTRAVE TË SHKOLLAVE TË ARSIMIT 9 VJEÇAR DHE TË MESËM PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE SPORTEVE PAS PROGRAMIT MËSIMOR DHE NË DITËT E PUSHIMIT
4. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit të Këshillit	PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS SË KËSHILLIT TË BASHKISË DURRËS PËR PERIUDHËN JANAR 2022 – DHJETOR 2022
5. Shqyrtim dhe miratim i projekt-vendimit të Këshillit	PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 617, DATË 02.08.2019 “PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE, QË DO TË PËRFAQËSOJNË KËSHILLIN BASHKIAK NË KËSHILLIN E QARKUT DHE PAISJEN ME MANDATIN E PËRFAQËSIMIT”
Pika 6.	Siç jeni vënë në dijeni është hequr me kërkesë të Bashkisë
Pika 7.	Siç jeni vënë në dijeni është hequr me kërkesë të Bashkisë
<b>Shtesë Pika 8.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT NË NJËSITË ADMINISTRATIVE NR. 1, 2, 5 DHE ISHËM, BASHKIA DURRËS, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR BANESAT INDIVIDUALE TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019
<b>Shtesë Pika 9.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E DISA SHTESAVE NË ANEKSIN 2, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 22, DATË 25.02.2021 “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË SUBJEKTEVE PËRFITUES, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR. 1062, RRUGA “26 NËNTORI” DHE PALLATIN NR.14, RRUGA “PETRAQ BOSHNIJAKU”, NJËSIA ADMINISTRATIVE NR.2, TË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E

	TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”, I NDRYSHUAR
<b>Shtesë Pika 10.</b> Shqyrtim dhe miratim i projektvendimit	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESE NË ANEKSIN 1, TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK NR. 28, DATË 05.03.2021, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE, QË DO TË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I PROÇESIT TË RINDËRTIMIT PËR PALLATIN NR.458, RRUGA “BAJRAM TUSHA”, I DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019” I NDRYSHUAR
Pyetje nga këshilltarët	DISKUTIME DHE PYETJE NGA KOMUNITETI

**Ani Dyrmishi** : Atëherë përse i përket rendit të ditës kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? ..... Nuk ka.

*Atëherë me 35 vota pro miratohet rendi ditës.*

- Atëherë kalojmë në shqyrtimin e **pikës parë të R.D**, i japim fjalën Komisionit të Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale, znj. Klementina Meçi.

**Klementina Meçi:** Faleminderit Kryetar! Përshëndetje të gjithëve! Komisioni Barazisë Gjinore dhe Mirëqënies Sociale mori në shqyrtim pikën e parë të rendit të ditës, konkretisht sipas projektvendimit të dorëzuar nga bashkia e Durrësit dhe vendos miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat dytësore për 94 familje dhe miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga fondi 6 % për 22 familje. Nga sa më sipër komisioni vendosi që me vota unanime të miratohet projektvendimi dhe të kalohet për votim në mbledhjen e ditës së sotme. Faleminderit !

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Atëherë përse i përket pikës 1, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka komente. Kush është pro miratimit të pikës 1 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? .....Nuk ka.

*Atëherë me 35 vota pro miratohet pika 1 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 2 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Alneida Roshi.

**Alneida Roshi** : Përshëndetje! Komisioni Rregullores dhe Çështjeve Juridike për pikën 2 të rendit të ditës “Për miratimin e përbërjes dhe funksionimit të Këshillit Teknik Konsultativ”, propozoj në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 2. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Roshi. Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës znj. Velçani.

**Etleva Velçani** : Përshëndetje! Edhe Komisioni Zhvillimit Urban dhe Përdorimit të Tokës pasi shqyrtoi të gjithë dokumentacionin vendosi me vota unanime kalimin në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 2 nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 2 të rendit të ditës? Kundra ?.... Apstenim ?..... Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 2 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 3 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit të Buxhetit, Financës Taksave-Tarifave znj.Pamela Bardhaj.

**Pamela Bardhaj**: Faleminderit z. Kryetar! Komisioni ynë, vendosi pro miratimit të pikës 3. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit znj. Bardhaj. Komisioni Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit znj. Jolanda Mustafaraj.

**Jolanda Mustafaraj**: Përshëndetje të gjithëve! Dhe Komisioni Arsimit, Rinisë dhe Kulturës vendosi që të kaloj pika 3 e rendit të ditës.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Atëherë komente përsa i përket pikës 3 të rendit të ditës kemi nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka, atëherë kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 3 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?.....Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 3 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 4 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Rregullore dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

**Alneida Roshi** : Komisioni Rregullore “Për miratimin e programit të punës së Këshillit të Bashkisë Durrës për periudhën janar – dhjetor 2022”, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 4. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 4 nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 4 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ?.... Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 4 e rendit ditës.*

- Kalojmë në shqyrtimin e **pikës 5 të rendit të ditës** i japim fjalën Komisionit Mandateve znj. Ana Dhamo.

**Ana Dhamo**: Komisioni Mandateve pasi shqyrtoi relacionin dhe projektvendimin, vendosi me vota unanime që të kaloj në votim në Këshillin Bashkiak sot. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Përsa i përket pikës 5, komente nga ana e këshilltarëve kemi?

Nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 5 të rendit të ditës?

Kundra?.... Apstenim ? .....Nuk ka.

Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 5 e rendit ditës.

- **Pika 6 dhe 7**, siç jeni në dijeni janë hequr nga rendi i ditës.
- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 8**, i japim fjalën për projektvendimin e pikës 8, Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

**Alneida Roshi** : Komisioni Rregullores dhe për pikën 8, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar në votim. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

**Elio Jani** : Përshëndetje të gjithëve. Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike mori në shqyrtim pikën 8 të rendit të ditës për ditën e sotme dhe në përfundim vendosi miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Përsa i përket pikës 8, kemi komente nga ana e këshilltarëve? Atëherë komente nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 8 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? ..... Nuk ka.

Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 8 e rendit ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 9**, i japim fjalën për këtë projektvendim, znj. Alneida Roshi.

**Alneida Roshi** : Komisioni Rregullores propozon unanimitisht pikën 9 të rendit të ditës. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

**Elio Jani** : Edhe për pikën 9, Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë dhe propozon miratimin e saj. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 9, kemi nga ana e këshilltarëve? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 9 të rendit të ditës? Kundra?.... Apstenim ? ..... Nuk ka.

Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 9 e rendit ditës.

- **Kalojmë në shqyrtimin e pikës 10**, i japim fjalën Komisionit Rregullores dhe Çështjeve Juridike znj. Roshi.

**Alneida Roshi** : Komisioni Rregullores pasi mori në shqyrtim pikën 10, “Për miratimin e një shtese në aneksin 1, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 28, datë 05.03.2021”, propozon në mënyrë unanime për ta kaluar pikën 10. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike z. Jani.

**Elio Jani** : Edhe për pikën 10, Komisioni Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakort me propozimin e bashkisë. Faleminderit.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Komente përsa i përket pikës 10, nga ana e këshilltarëve kemi? Atëherë nuk ka, kalojmë në votim. Kush është pro miratimit të pikës 10 të rendit të ditës? Kundra?... Apstenim ? ..... Nuk ka.

*Atëherë miratohet me 35 vota pro dhe pika 10 e rendit ditës.*

- Ka **kërkuar fjalën** nga ana e këshilltarëve znj. Flutura Kasa.

**Flutura Kasa** : Përshëndetje të gjithëve. Kisha një pyetje për këto shtëpiat ds5, ku familjarët kanë kaluar me transferim, sepse nuk ju..., për arsye teknike. Tashi këto shtëpia nga kush do shëmben, se mos bëjnë probleme rreziku.

**Emiriana Sako** : Bashkia ka marrë masat hap pas hapi me programin e rindërtimit dhe duke vijuar me procedurat e miratimit për shembjet për objektet që “Ne” kemi patur në prioritet ose që janë shpallur si fitues, pra familjet që kanë përfituar. Dhe “Ne” do të marrim dhe një vendim për shembjen e objekte, pavarësisht janë apo jo fitues familjet, për të vijuar procedurën. Nuk kryhet realisht nga bashkia e Durrësit direkt këto ndërhyrje, kryhen dhe nga IKMT e Tiranës , pasi do një ekspertizë dhe një staf të specializuar në këtë fushë.

Gjithashtu ka pasur dhe raste që vet pronarët e këtyre objekteve me ekspertiza private apo duke marrë opinionca teknike në Institut duhe hartuar projekte të detajuara në mënyrë private si të thuash, kanë marrë masat që të përforcojnë objektet dhe kanë garantuar, që kjo nuk arrin një vlerë të caktuar në zbatim të ligjit, si të thuash. Dhe pikërisht për këtë arsye nuk i kemi marrë masat të tilla, pasi kemi lënë pak një hapsirë kohore të nevojshme për këto familje, të cilat nuk kanë, pavarësisht se objekti me ekspertizë të Institutit thotë për shembje, kanë dashur ta riparojnë për arsye të zgjedhjes që ata kanë bërë me këto godina. Në mbledhjet në vijim “Ne” do të vijojmë dhe me këto raste duke ndërhyrë dhe në territor pastaj për shëmbjen e objekteve.

**Flutura Kasa** : Të falenderoj shumë.

Kisha dhe dy fjalë të lutem. Më shumë e kisha me grupin socialist, pasi prita një reagim në mbledhjen e kaluar pas disa intervistave të herë pas herëshme të një ish zyrtari, që tani është shkarkuar. Mund të thoni Ju pse po flet ti. Momenti që unë kam dhënë votbesim, asaj vajzës së nderuar aty dhe që po jep maksimumin për qytetin, e ndjej që të them vetëm dy fjalë.

Një zyrtar, që ulet në karrike 9 vjet dhe kujtohet pas 9 vjetëve të nxjerrit mllëfin nëpër televizione, pikë së pari diçka e vogël u donte nga ana jonë për ta mbrojtur atë vajzë aty, që “Ne” i kemi dhënë votbesimin. Dhe një akuzë qesharake aty, për mua është qesharake, që të akuzoj Kryetaren që drejton gjithë qytetin tonë se takohet me një ish-Kryetar të nderuar, për mu. Dhe është detyra e asaj për të takuar jo vetëm atë, por shumë Kryetar që kanë qënë aty në atë detyrë. Dhe nuk është armik i popullit ai pse e takojmë “Ne” për të pirë kafe. Thjesht unë i them Kryetares Bashkisë je në rrugën e duhur dhe vazhdo kështu si je se je ok, dhe ke dhe

mirëkuptimin e njerëzve përjashtë. E ndjej për detyrë për t'i thënë këto fjalë, pasi sa herë kam trokitur në derën Tuaj, kam pasur mbështetjen Tuaj për hallet e njerëzve, që janë jashtë. Nuk kam asgjë kundër grupit socialist, por përderisa "Ne" të kemi dhënë votbesimin, na takon që dhe të mbështesim gjatë gjithë rrugës që je në atë detyrë. Kaq kisha.

**Ani Dyrmishi** : Faleminderit. Atëherë këshilltarë tjetër nuk e ka kërkuar fjalën, duke qënë se arritëm në përfundim të mbledhjes. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur dhe i falenderoj të gjithë pjesmarrësit.

*Ky procesverbal mbyllet me nr.rendor 7(shtatë) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset sipas Rregullores së Funkcionimit të KB nga Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit.*

**Mbajtësi i proçesverbalit:** Dorina Milja

### **Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :**

Kryetari Këshillit Bashkiak :

ANI DYRMISHI

Sekretare e Këshillit Bashkiak :

DORINA MILJA

Kryetari Grupit të Partisë Socialiste të KB :

ELIO JANI

Kryetare Grupit të Pavarur të KB :

ETLEVA VELÇANI